



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 418/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Pokret Za Demokratski Prosperitet (PDP), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Pokret Za Demokratski Prosperitet (PDP).

### Arsyetim

Me datë 27.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Pokret Za Demokratski Prosperitet (PDP) paraqitur ndaj ndaj numrit përfundimtar të votave nga personat e zhvendosur dhe nga Votuesit Jashtë Kosovës. Parashtruesi i ankesës lidhur me këto parregullsi dhe dyshimet për këtë proces ka paraqitur deklaratën me shkrim të nënshkruar nga drejtori i OJQ-së nga Nishi lidhur me ofrimin e ndihmës për KQZ-në lidhur me zbatimin e zgjedhjeve në bazë të marrëveshjes, si dhe deklaratën e nënshkruar nga ana e personit fizik të zhvendosur nga Kosova në Nish për të cilin ekziston dyshimi se ishte i manipuluar gjatë procesit të votimit. Parashtruesi i ankesës thekson se votimi jashtë Kosove në këtë rast ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me rregullat zgjedhore dhe se kërkon nga PZAP-i që të anulohen rezultatet e votimit jashtë Kosovës të organizuara në Serbi dhe të përsëritet edhe njëherë ky proces i votimit.

PZAP-i pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, lidhur me rastin në fjalë ka zhvilluar hetime më parë për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore për të cilin rast është parashtruar një ankesë edhe më parë nga subjekte të ndryshme politike dhe se PZAP-i me qëllim të hetimit të mëtejshëm të rregullsisë dhe vlefshmërisë së këtyre fletëvotimeve bazuar në nenin 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar dy anëtarë të panelit dhe një hetues kryesor të sekretariatit për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosove që vijnë nga Republika e Serbisë, dhe ky hetim është bërë në QNR për ti

vërtetuar pretendimet lidhur me dyshimet se fletëvotimet nga votuesit jashtë Kosove janë plotësuar nga i njëjti person, nga i njëjti laps-kimik dhe janë të mbushura e pastaj të fotokopjuara. Nga ekipi hetues i PZAP-it , nga të gjitha kutit e votimit të hapura nga komunat e ndryshme ka verifikuar 800 fletëvotime nga numri i përgjithshëm prej 8551 fletëvotime nga votuesit jashtë Kosove nga Republika e Serbisë dhe më atë rast nga ky numër i fletëvotimeve të hetuara ka rezultuar se 49 fletëvotime kanë qenë të dyshimta dhe të njëjtat janë proceduar dhe janë vlerësuar në panel të zgjeruar. Pas hetimit të fletëvotimeve të dyshimta PZAP-i, ka konstatuar se asnjë fletëvotim nuk ka qenë i fotokopjuar pasi që më parë është plotësuar respektivisht klikuar subjekti politik dhe 5 kandidatët e tij, por ka gjetur se fletëvotimet në fjalë kanë qenë të fotokopjuara e pastaj të plotësuara individualisht me laps-kimik.

Nga kjo rezulton se pretendimet ankimore kryesisht i referohen shkeljeve potenciale zgjedhore me rastin e votimit të Votuesve Jashtë Kosove – nga Republika e Serbisë, për të cilat pretendime PZAP-i në vendimin e tij të plotfuqishëm A.Nr. 368/2014 të datës 18.06.2014, ka dhënë qëndrimin e vet në ankesat e paraqitura nga gjashtë subjekte politike Aleanca Kosova e Re (AKR), Nisma për Kosovën, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të gjitha me seli në Prishtinë dhe Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Graçanicë.

Ndërsa edhe në këtë ankesë, përsëriten të njëjtat pretendime, për të cilat PZAP ka vendosur njëherë. Këto pretendime sipas vlerësimit të PZAP-it nuk i referohen keq numërimit të votave, përkatësisht administrimit të numërimit të votave në QNR në kuptim të nenit 105 të LZP, për të cilin shkak në këtë fazë të procesit zgjedhor është e lejuar e drejta e ankimit. Andaj për këto arsye nuk mund të pranohet as propozimi i ankuesit për rivotim. Për më tepër ata persona që dyshojnë në keq përdorimin e votës se tyre mund të drejtohen Prokurorisë së Shtetit me pretendim se kanë bërë veprë penale keqpërdoruesit e tillë.

Andaj mbi këtë bazë PZAP-i konsideron se pretendimet e parashtruara në ankesë janë të pabazuara dhe në mbështetje të në nenit 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 418/2014 më datën 30.06.2014



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.